



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/198
Datë: 02.04.2024

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2024, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti në Fushën e Aviacionit Civil.
2. Obligohet Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog
PlaniranjaMinistry of Environment and Spatial
Planning

KONCEPT DOKUMENT NË FUSHËN E AVIACIONIT CIVIL

Përgatitur nga: Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe
Infrastrukturës

Dhjetor, 2023

Përmbajtja

Përmbledhje e koncept dokumentit	3
Hyrje.....	8
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit	10
Elaborimi i Shkaqeve	28
Elaborimi i efekteve	29
Kapitulli 1.3. Zbatimi i acquis së BE-së	31
Kapitulli 2: Objektivat	34
Kapitulli 3.1: Opsioni i parë - Opsioni asnjë ndryshim.....	38
Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit.....	38
Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë -Ligji i ri për Aviacion Civil.....	39
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme.....	41
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave	43
Kapitulli 6: Krahësimi i opsioneve	44
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme	47
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm.....	51
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin	51

Përmbledhje e koncept dokumentit

Koncept dokumenti për fushën e sektorit të aviacionit civil përgatitur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është në përputhje me Udhëzuesin dhe Doracakun për Hartimin e Koncept Dokumenteve Nr. 95/2018 të datës 21/03/2018 dhe në përputhje me rregullat dhe procedurat e Qeverisë.

Ofrimi i Shërbimeve të Transportit Ajror në baza të sigurtë ka rëndësi të veçantë për funksionimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të çdo vendi duke pasur parasysh se ofrimi i shërbimeve të transportit ajror ndikon në qarkullimin e udhëtareve dhe mallrave në mes shteteve që ka impakte të zhvillimit ekonomik ndërmjet tyre.

Qëllimi i këtij koncept dokumenti është që të ofroj një analizë të përgjithshme për sektorin e aviacionit civil për të arritur harmonizimet e duhura në mes të institucioneve përgjegjëse që kanë dhe zbatojnë kompetenca në sektorin e aviacionit civil në mënyrë që të ndikoj edhe më tej në zhvillimin e sektorit të aviacionit civil duke u bazuar dhe pasur prioritet kryesor zbatimin e Marrëveshjes HPEA. Sektori i Aviacionit Civil, sa i përket rregullim ekonomik të aeroporteve, shërbimeve të navigacionit ajror dhe transportit ajror është i një rëndësie të veçantë. Synimi i përgjithshëm i këtij koncept dokumenti është që të krijohet korniza e duhur ligjore e cila mundëson ngritjen e mëtejme të sektorit të aviacionit civil, në funksion të zhvillimit të shërbimeve transportit ajror, sigurisë (safti në tekstin e mëtejshëm) dhe siguri (security në tekstin e mëtejshëm). Kjo përfshin

- (DSF) certifikim dhe mbikëqyrje të sigurisë së operimeve ajrore, vlefshmërisë ajrore dhe licencimit të personelit, regjistrimin e mjeteve ajrore, operimet e specializuara, transportin e mallrave të rrezikshme, fluturimet rekreative, organizatat dhe personelin e certifikuar, dhe vlerësimin e sigurisë së mjeteve të huaja ajrore (SAFA);
- (AGA) dhe certifikimin, aprovimin dhe regjistrimin të aerodromeve;
- (SHNA) është përgjegjës për rregullimin, monitorimin, inspektimin, certifikimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sigurisë së Ofruesve të Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Me këtë koncept dokument janë identifikuar dhe analizuar mangësitë e legjislacionit aktual në sektorin e aviacionit Civil të cilat kanë ndikim negativ në menaxhimin dhe harmonizimet e duhura të kompetencave funksionale në mes të autoriteteve përgjegjëse.

Me ligjin e ri për aviacion civil do të:

- (i) adresoheshin mangësitë e ligjeve aktuale në veçanti sa i përket mangësive të rregullimit ekonomik të transportit ajror në mes MMPH dhe AAC, dhe do bëhet transpozimi i koncepteve dhe parimeve të legjislacionit të BE-së;
- (ii) mangësitë e legjislacionit aktual në fushën e sigurimit të aviacionit civil që kanë ndikim negativ në menaxhimin e resurseve njerëzore dhe infrastrukturore në rritjen dhe përmirësimin e sigurimit të aviacionit civil në Republikën e Kosovës.
- (iii) duhet të garantohen edhe pagat e stafit profesional të aviacionit të MMPH dhe ato duhet të jenë të njëjta me të AAC, përndryshe do të këtë ndikime negative për ruajtjen

dhe përmirësimin e kapaciteteve njerëzore në këtë Ministri.

Kjo realizohet duke qenë në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-197 Për Zyrtarët Publik, të behet rregullimi, përmes Ligjit të Aviacionit Civil, si ligj i veçantë, për të gjithë zyrtarët e Autoritetit të Aviacionit Civil, si nëpunës civil me status të veçantë.

Përmirësimi i kornizës së duhur ligjore, për t'i mundësuar Ministrisë së Punëve të Brendshme ruajtjen/mbajtjen e nivelit për siguri të aviacionit civil sipas standardeve ndërkombëtare është prioritet, duke specifikuar detyrat dhe përgjegjësit e MPB-së në fushën për siguri të aviacionit civil, si autoriteti i vetëm mbikëqyrës dhe rregullator i fushës së sigurimit të aviacionit civil në Republikën e Kosovës.

Në fushën për siguri të aviacionit civil, ligji i ri do të përmirëson mangësitë e ligjit aktual në veçanti organizimin dhe mbikëqyrjen për siguri të aviacionit civil dhe standardet bazë dhe masat e përgjithshme për siguri të aviacionit civil.

Me ligjin e ri, synohet që MPB-ja për fushën për siguri të aviacionit civil t'i garantohen kompetencat e duhura ligjore për të ruajtur sigurinë e aviacionit civil në Republikën e Kosovës përfshirë sigurinë e pasagjerëve, ekuipazhit, personelit në terren, publikun, aeroplanët dhe pajisjet e një aeroporti që shërbejnë për aviacionin civil, kundër akteve të ndërhyrjeve të paligjshme të kryera në tokë ose në fluturim.

MPB-së duhet t'i garantohen kompetencat ligjore për zbatimin e masave të kontrollit të kualitetit dhe kompetencat e nevojshme për zbatim të ligjit për të siguruar se çdo defekt i identifikuar është adresuar në mënyrën e duhur nga subjektet që merren me siguri të aviacionit civil. Për t'i kryer këtë kompetencë MPB-ja në fushën për siguri të aviacionit civil dhe për ta ruajtur stafin profesional të saj duhet të përcaktohet ligjërisht se pagat e zyrtarëve për siguri të aviacionit civil brenda MPB-së duhet të jenë të njëjta me zyrtarët e Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Ky koncept dokument përveç që është pjesë e PKZH, e politikës strategjike të Qeverisë së Republikës Kosovës (Strategjia e Transportit Multimodal 2023-2030.) gjithashtu lidhet edhe me zbatimin Acquis-it të BE-së, konkretisht me kapitullin 14, (Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit PKZMSA 2022-2026), respektivisht fushën që lidhet me politikat e transportit.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, i cili ofron shërbime për pasagjer dhe avio kompani ajrore është i vetmi aeroport ndërkombëtar i vendit që shërben si portë hyrëse e Kosovës drejt botës. Si aeroporti i rikupëruar më shpejt në Evropë pas pandemisë, ANP është një nga aeroportet më të ngarkuara në rajon dhe i dyti për sa i përket rritjes vjetore të pasagjerëve pas pandemisë. Angazhimi i ANP-së për transformimin dhe inovacionin dixhital rezultoi në përvojën plotësisht të automatizuar dhe pa prekje të pasagjerëve si e ardhmja e udhëtimit ajror.

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept Dokumenti në Fushën e Aviacionit Civil
Ministria bartëse	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Personi kontaktues	Avdi Kamerolli, Drejtor i Departamentit të Aviacionit Civil - MMPHINr. tel. 038 200 28 450

Plani Strategjik Operacional	Plani Kombëtar për Zhvillim PKZH 2023 – 2025 Shtylla I; 08- Transporti dhe komunikimi; Pika 2.3 - Përmirësimi infrastrukturës dhe shërbimeve të transportit.
Prioriteti strategjik	Strategjia Sektoriale e Transportit Multimodal 2023-2030 1.1.Objektivi strategjik 3 6.3.1 Lidhja e Kosovës globalisht
	6.3.3 Aviacioni i zgjuar dhe i qëndrueshëm PKZH 2023-2025. 32.Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar në fushën e aviacionit civil. 3.5.6 Hartimi i Koncept Dokumentit për Ligjin për Aviacion Civil Lista e koncept dokumenteve për vitin 2023.

Vendimi nr. 4912 datë 13.06.2023	
Çështja kryesore	Mungesa e rregullimit adekuat ligjor dhe mos harmonizimi i ligjeve ekzistuese
Përmbledhje e konsultimeve	Gjatë hartimit të koncept dokumentit në fushën e aviacionit Civil në përputhje me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011 si dhe Rregullores (QRK) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik, ekipi punues ka zhvilluar takime dhe me datën 27.06.2023 janë mbajtur takimi me grupet e interesit në fazën e hershme janë ftuar në takim AAC, KHAIA, Departamenti i Sigurimit të Aviacionit Civil nga Ministria e Punëve të Brendshme në të cilin takim janë shqyrtuar ndryshimet e pretenduara të ligjit për aviacion civil. Do të plotësohet me tej... Nga data 25.10.2023, deri me datën 16.11.2023, janë mbajtur konsultimet publikë me grupet e interesit dhe janë pranuar gjithsej 28 komente.
Opsioni i propozuar	Opsioni 3

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Ligji i ri për Aviacionin Civil nuk krijon kosto shtese.

Ndikimet ekonomike	Hartimi i ligjit të ri për aviacion civil pritet të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e mëtejshëm të Aviacionit : - Rregullimi ekonomik efektiv i transportit ajror; - Harmonizimi i përgjegjësiwe sektoriale ndërmjet institucioneve përgjegjëse që krijojnë mundësi për zhvillim ekonomik; - Ndarja e përshtatshme e kompetencave në sektorin e aviacionit civil ndërmjet institucioneve të cilat ndikojnë në krijimin e kushteve optimale për ndikimin e rritje ekonomike kur ekziston një rregullim adekuat institucional. - Rritja e numrit të avio udhëtarëve; - Zhvillimi i tregut të transportit ajror.
Ndikimet shoqërore	- Ligji i ri do të ndikon në rritjen e tregut të transportit ajror dhe do të krijojnë mundësi dhe lehtësime për mbajtjen e lidhjeve të shtetit të Kosovës me diasporën tonë dhe me shtetasit e shteteve tjera.
Ndikimet mjedisore	- Reduktimi i efekteve relativisht të mëdha negative mjedisore të shkaktuar nga transporti ajror, nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve të mëtejshme për normalizimin e hapësirës së ulte ajrore, ku do të shkurtohet distanca e fluturimeve në destinacionet në shkuarje dhe ardhje, shkurtimi i distancave, ka impakt në zvogëlimin e konsumit të karburantit dhe rezulton zvogëlimin endotjes mjedisore.
Ndikimet ndër-sektoriale	- Do të ketë ndikim ndërsektorial, duke reflektuar bashkëpunimin dhe koordinimin me të mirë ndërmjet Ministrisë përkatëse për transport ajror, AAC-se, ASHNA-se, Departamentit përkatës për siguri të aviacionit civil dhe KHAIA. Si rezultat i kësaj do të ketë ndikim direkt në të drejtat e qytetarëve të cilëve do të mundësohen shërbime më të sigurt dhe më të shpejta me kosto më të ulët ekonomike dhe mjedisore, kursime në të holla, kohë sidhe logjistikë më bashkëkohore.
Ngarkesat administrative për kompanitë	- Një nga çështje kryesore të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është krijimi i rregullave të përshtatshme për zvogëlimin e ngarkesave administrative për avio kompanitë ajrore dhe pronaret e fluturimeve në fushën e aviacionit civil, apo ngarkesat administrative aty ku është domosdoshme të aplikohen të bazohen në kosto.
Testi i NVM-ve	- Fusha e aviacionit civil është e rregulluar sipas standardeve dhe praktikave ndërkombëtare, dhe rrjedhimisht është e pamundur të aplikohen standarde më të ulta për NVM. Ndikimi në NVM parashihet të jetë pozitiv, pasi që do të krijojnë mundësi të reja për rritjen e numrit të fluturimeve, dështimin e destinacioneve të reja për dhe nga Aeroporti i Prishtinës.
Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	Pas miratimit të koncept dokumentit, pritet të hartohet Ligji i ri për Aviacion Civil
Afatmesëm	Me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit për Aviacion Civil do të sigurohet zbatimi i plotë i ligjit nëpërmjet mekanizmave adekuate dhe nxjerrjes së akteve nënligjore

Hyrje

Rregullimi adekuat në sektorin e Aviacionit Civil me legjislacion primar dhe sekondar, është një nga faktorët themelorë për zhvillimin e transportit ajror dhe arritja e sigurisë së duhur në transportin ajror.

Nga të gjitha fushat tjera të transportit, transporti ajror është sektori më i unifikuar dhe i rregulluar. Rregullativa bazohet në Aneksin e ICAO dhe Marrëveshja Multilaterale HPEA, pjesë e së cilës është dhe Republika e Kosovës, përcakton rregullat dhe obligimet të cilat duhet të zbatohen në secilin shtet anëtarë. Përmbushja e rregullave, standardeve dhe praktikave më të miratë përcaktuara monitorohen dhe auditohen nga ekspertet e organizatave evropiane në mënyrë sistematike.

Koncepti i dokumentit ofron analizë gjithëpërfshirëse për politikat, ruajtje të resurseve njerëzore, legjislacionin dhe opsionet për përmirësimin e sigurimit të aviacionit civil në Republikën e Kosovës, referuar standardeve dhe parimeve ndërkombëtare të cilat MPB-ja ka synim t'i arrijë.

Me ndryshimin e Ligjit për Aviacion Civil nr.03/L-051, me Ligjin NR. 08/L-063, ishte normale të vlerësohen dhe ndryshohen vetëm çështjet që ndërlidhen me llogaridhënien e AAC se ku duhet të jep llogari në Ministri ose në Qeveri apo në Kuvend, por zyrtaret të caktuar ndërhynë në ndryshime

të thella sektoriale të Ligjit për Aviacion Civil, pa i pasur kompetencat ligjore të duhura, pa ekspertizën e duhur dhe pa vlerësimin e duhur duke shkaktuar ngatërime ligjore të mëdha;

këto ngatërime ligjore qysh tani paraqesin probleme me zbatimin e ligjit, janë si rezultat se personat me njohuri të specializuara dhe me përvojë në këtë fushë nuk i kanë involvuar në procesin e shqyrtimit të këtij ligji dhe nuk i kanë ftuar as në Komisionet Funksionale të Kuvendit të Kosovës dhe si rezultat i kësaj tani dalin plotësisht mangësi dhe ngatërresa ligjore.

Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për konceptin e dokumentit

Titulli	KONCEP DOKUMENTI NË FUSHËN E Aviacionit Civil
Ministria bartëse	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Departamenti i Aviacionit Civil
Personi kontaktues	Avdi Kamerolli, Drejtor i Departamentit të Aviacionit Civil në MMPHInr. tel.+381 (0)200 28 450

Plani Strategjik Operacional	Plani Kombëtar për Zhvillim PKZH 2023 – 2025 Shtylla I; 08- Transporti dhe komunikimi; Pika 2.3 - Përmirësimi infrastrukturës dhe shërbimeve të transportit; Objektivi operacional Hartimi i Koncept Dokumentit për Ligjin për Aviacion Civil Lista e Koncept Dokumenteve 2023
---------------------------------	---

Prioritet i strategjik	Strategjia Sektoriale e Transportit Multimodal 2023-2030 6.3.1 Lidhja e Kosovësglobalisht 6.3.3 Aviacion i zgjuar dhe i qëndrueshëm PKZH 2023-2025 Hartimi i projekt Ligjit për Aviacion Civil 1.1.Objektivi strategjik 3 Përmisimi i Sigurisë, Sigurimit dhe Trafikut në Transportin Ajror
Grupi punues	Me vendimin nr. 4912 datë 13.06.2023, Sekretari i Përgjithshëm emëron grupinpunues për hartimin e koncept dokumentit, në këtë përbërje: 1. Avdi Kamerolli, kryesues, DAC/MMPHI 2. Nexhat Bala, zëvendës kryesues, DAC/MMPHI 3. Agon Krasniqi, anëtar -ASHNA 4. Kastriot Gashi, anëtar, DSP/MPB 5. Ilir Muçaj, anëtar, ZKM 6. Njomza Beqiri, anëtare, DL/MMPHI 7. Saranda Jusufi, anëtare, DIEKP 8. Emine Krasniqi , anëtare, DFSHP/MMPHI 9. Nora Bakalli, anëtare, AAC
Informata shtesë	Hartimi i koncept dokumentit rrjedh nga obligimet e Republikës së Kosovës sipas Marrëveshjes së Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit HPEA.

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Koncept dokumenti për Aviacionin Civil synon që të identifikoj mungesat dhe zbrazëtirat në Ligjet Ekzistuese si dhe harmonizimin e plotë me acquis e BE-se.

Ky koncept dokument në mënyrë specifike duhet të parasheh përveç tjerash edhe fshirjen e paragrafit 2 të nenit 95, të Ligjit për Aviacion Civil që është kërkesë e Komisionit Evropian për të kaluar nga faza I në fazën II ne kuadër HPEA. Kjo është njëra prej shkaqeve që Ministria tani duhet ti filloj procedurat e ndryshimit të Ligjit për Aviacion Civil.

Ligji nr. 08/L-063, që e patë ndryshuar Ligjin për Aviacion Civil:

Pate kaluar ne fazën e konsultimeve publike, e cila u pate publikuar ne platformën e konsultimeve publike pa kompetencat e MMPHI, dhe me vone i kane filluar ndryshimet e tij për marrjen e kompetencave të Ministrisë konsiderojmë në bazë të ndikimit të grupeve të interesit;

Kompetencat e Ministrisë për rregullim ekonomik të transportit ajror dhe nxjerrjen e rregullorevetë zbatimit lidhur me ekonominë e transportit ajror i kanë hequr nga neni 6 i

ligjit bazik, por kompetencat e hequra nuk i kane bartur te kompetencat e AAC, shih nenin 30, paragrafin 1 te këtijligji te miratuar, shih nenin 31 i cili e ndryshon nenin 15 te ligjit bazik shih 15.1 piken e);

Neni 36 nuk është i harmonizuar me nenin 35 dhe ka përzierje te kompetencave ne mes Ministrisëdhe AAC, neni 35 i ligjit bazik nuk është shfuqizuar;

Ndryshimet që janë bërë në Ligjin e Aviacionit Civil nr.03/L-51, me Ligjin NR. 08/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e vijaveLlogaridhënës (Ligjin NR. 08/L-063), i cili është shpallur ne gazetën zyrtare me datën 5 shtator 2022 dhe është hyrë ne fuqi me datën 20 shtator 2022, ka ndikuar që te iniciohet ndryshimi i ligjitpër aviacion civil për te harmonizuar te gjitha çështjet te cilat janë shkaktuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.08/L-063.

Ligji nr.08/L-063 ka shkaktuar ngatërtime ligjore ne mes MMPHI dhe AAC, dhe tani paraqesin probleme me zbatimin e këtij ligji, këto ngatërtime ligjore janë si rezultat se personat me njohuri te specializuara dhe me përvojë ne këtë fushe nuk i kane involvuar ne procesin e shqyrtimit te këtijligji dhe nuk i kane ftuar as ne Komisionet Funksionale të Kuvendit të Kosovës dhe si rezultat i kësaj tani dalin plotë mangësi dhe ngatërresa ligjore.

Ligji i ri do te përmirëson bazën ligjore për obligimet qe rrjedhin ne fushën e sigurimit te aviacionitcivil duke u bazuar ne standarde ndërkombëtare e sidomos do te përmban referencat ligjore për mbikëqyrje dhe kontroll (kryerjen e auditimeve të sigurisë, inspektimeve, hetimeve të sigurisë, testeve infilturse dhe anketa/sondazhe) në fushën e sigurisë së aviacionit civil, te cilat na kanë krijuar shpeshherë vështirësi në realizimin e detyrave dhe përgjegjësitë që ka MPB-ja në fushën esigurisë së aviacionit civil. Ligji i ri do të trajtojë edhe rregullimin e përgjithshëm të fushës për përdorimin e dronëve, si fushë e cila po zhvillohet me një rritje të shpejtë. Në këtë vazhdë, do të rregullohet çështja e zyrtareve të cilët pas përfundimit të trajnimeve obligative iu ipen kredencialet për inspektor të sigurisë së aviacionit civil.

Gjithashtu, MPB-ja është duke u ballafaquar me largim/ikje të personelit që merret me siguri të aviacionit civil, pasi pajisen me kredenciale të inspektorit për siguri të aviacionit civil. Kjo po ndodh për shkak të dallimit të pagave me zyrtarët tjerë në fushën e industrisë së aviacionit civil nëRepublikën e Kosovës, ku neni 4 i ligjit për aviacionin civil *“pozitë kyçe e cila ka të bëjë me aviacioni”* nuk e bënë këtë ndarje.

Procesi i hartimit të këtij koncept dokumenti ka filluar si mënyrë për të adresuar problematiken sidhe për të përmirësuar kornizën e legjislacionit në fushën e aviacionit civil.

Institucionet kryesore që janë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave ligjore siç përcaktohet në Ligjin aktual për aviacion janë:

- a) Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Transportit -

- Departamentipërkatës për Aviacion Civil;
- b) Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës;
- c) Ministria e Punëve të Brendshme – Divizioni për Siguri në Aviacionin Civil;
- d) Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Transportit – Departamenti i Aviacionit Civil
Përgjegjësitë themelore të Ministrit dhe Ministrisë.

Ministria është përgjegjëse për:

Zhvillimin e politikave kombëtare për transportin ajror;
 Organizimin, zbatimin dhe/ose marrjen e masave për zhvillimin e Aviacionit Civil në Kosovë dhe bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e Aviacionit Civil;
 Udhëheqë në zhvillimin e politikave dhe programeve të Aviacionit Civil, si dhe përgatitë rekomandime për shqyrtim dhe miratim nga Qeveria e Republikës së Kosovës;
 Promovimin, merr përsipër përpilimin, mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave teknologjike, statistike, ekonomike, si dhe të dhënave të tjera të cilat kanë të bëjnë me Aviacionin Civil.

Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës

AAC është përgjegjëse për rregullimin e sigurisë së aviacionit civil dhe rregullimin ekonomik të aeroporteve dhe shërbimeve të navigimit ajror në Republikën e Kosovës, ka përgjegjësi edhe për te drejtat e trafikut dhe licencat e operatorit ajror (OL sipas Rregullores 1008/2008) të bartura me ndryshimin e LAC.

AAC ka statusin e Agjencisë rregullatore në pajtim me Ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe Agjencive të Pavarura. AAC ka kapacitet të plotë juridik. AAC është organizatë buxhetore dhe autoritet publik dhe i nënshtrohet dispozitave përkatëse mbi organizatat buxhetore dhe autoritetet publike në ligjet dhe aktet e tjera ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

AAC është përgjegjës për:

- a) Zbatimin e legjislacionit mbi aviacionin civil dhe zbatimin e politikave të miratuara nga Ministria ose Qeveria në fushën e Aviacionit Civil;
- b) Ofrimin e këshillave dhe propozimeve për Ministrinë, Qeverinë dhe Kuvendin lidhur me politikat dhe legjislacionin nga fusha e Aviacionit Civil;
- c) Nxjerrjen e rregullave të zbatimit dhe urdhrave për siguri të navigimit ajror, në përputhje me Ligjin bazik dhe Marrëveshjen HPEA, me qëllim të zbatimit të politikave të Aviacionit Civil të Ministrisë dhe legjislacionit përkatës nga fusha e Aviacionit Civil;
- d) Lëshimin e Licencave, Certifikatave dhe Lejeve në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë AAC-së;
- e) Rregullimin e sigurisë së transportit ajror në Republikën e Kosovës;
- f) Rregullimin ekonomik të tregut të aeroporteve dhe shërbimeve të navigimit ajror;
- g) Ofrimin e këshillave për Ministrinë në lidhje me përgatitjen e propozim-politikave mbi shfrytëzimin e hapësirës ajrore të Kosovës të cilat i përmbushin nevojat e shfrytëzuesve,

duke pasurparasysh sigurinë kombëtare, faktorët ekonomik dhe mjedisor, nevojën për standarde të larta të sigurisë;

h) Mbikëqyrjen dhe sigurimin e zbatimit në mënyrë efektive të legjislacionit, standardeve, rregullave, procedurave dhe urdhrave të aviacionit civil, përveç, kur me Ligjin bazik ose me një Akt tjetër juridik, ky funksion shprehimisht i është dhënë Ministrisë ose një autoriteti tjetër publik;

i) Shpërndarjen e informatave për publikun rreth çështjeve relevante mbi funksionet dhe aktivitetet AAC;

j) Në përputhje me dispozitat dhe qëllimin e Ligjit bazik, marrjen e masave, kryerjen e hetimeve, inspektimeve dhe nxjerrjen e urdhrave, rregullave, Rregulloreve dhe/ose procedurave të cilat AAC me arsye i konsideron të nevojshme për: (i) zbatimin e rregullt dhe të ligjshëm të dispozitave të Ligjit bazik ose (ii) ushtrimin e rregullt dhe të ligjshëm të kompetencave dhe detyrave të cilat ijanë dhënë AAC me Ligjin bazik;

k) Ushtrimin e funksioneve të tjera të cilat kanë të bëjnë me Aviacionin Civil në Kosovë, që janë dhënë sipas Ligjit bazik ose legjislacionit tjetër në fuqi.

l) DSF- certifikim dhe mbikëqyrje të sigurisë së operimeve ajrore, vlefshmërisë ajrore dhe licencimit të personelit, regjistrimin e mjeteve ajrore, operimet e specializuara, transportin e mallrave të rrezikshme, fluturimet rekreative, organizatat dhe personelin e certifikuar, dhe vlerësimin e sigurisë së mjeteve të huaja ajrore (SAFA).

m) (AGA) dhe certifikimin, aprovim dhe regjistrim të aerodromeve.

n) (SHNA) është përgjegjës për rregullimin, monitorimin, inspektimin, certifikimin dhe mbikëqyrjen e përgjithshme të sigurisë së Ofruesve të Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Ministria e Punëve të Brendshme – Divizioni për Siguri në Aviacionin Civil

Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për vendosjen dhe ruajtjen e sigurisë së aviacionit civil në Republikën e Kosovës, nga aktet e ndërhyrjeve të pa ligjshme.

Ministria e Punëve të Brendshme ka detyrimin e përgjegjësinë për hartimin, zhvillimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, rregulloreve, praktikave dhe procedurave për mbrojtjen e aviacionit civil nga aktet e ndërhyrjes së paligjshme, duke marrë parasysh sigurinë e operimit, rregullshmërinë dhe eficiencën e fluturimeve, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare.

Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për zbatimin dhe aderimin në konventat ndërkombëtare si dhe aspektet e *acquis communautaire* të BE-të të cilat kanë të bëjnë me sigurinë e aviacionit civil.

Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike

KHAIA është përgjegjëse për hetimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacion brenda Kosovës ku përfshihen avionët e regjistruar në Kosovë kudo qofshin ata. Kurdo që kërkohet ose është

e nevojshme, KHAIA do të punojë në bashkëpunim me organet e tjera kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat ushtrojnë funksione të njëjta. Kurdo që KHAIA kryen ose merr pjesë në një hetim të sipër cekur, KHAIA duhet të përgatisë një raport të hollësishëm lidhur me hetimin dhe t'ia dorëzojë këtë raport Qeverisë dhe Kuvendit sa më shpejtë që

të jetë e mundshme por jo më shumë se gjashtë (6) muaj pas përfundimit të hetimit.

Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni (-et) shtetëror(e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)
---	--	--	--

Ligji nr. 03/L-051 përAviacionin Civil	https://gzk.rks-gov.net/	MMPHI ,AAC, MPB, KHAIA	Mbikëqyrja, politikat zhvillimore, sigurinë dhesiguri ne aviacion civil, hetimi i aksidenteve dhe incidenteve në kuadër tëfushëveprimit të Ministrisë të MMPHI, MPB, AAC, KHAIA
Ligjin nr. 08/l-063 përndryshimin dhe plotësimin e ligjeve qëkanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura	https://gzk.rks-gov.net/	MMPHI, AAC	Politikat zhvillimore përaviacionin civil, bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën eaviacionit civil Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë të MMPHI
Rregullorja nr. 2008/6mbi rregullat e përbashkëta për alokimin e slloteve në aeroportet e vendosuranë Kosovë	https://gzk.rks-gov.net/	MMPHI	Mbikëqyrja dh erregullimi i slloteve në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë të MMPHI
Rregullorja nr. 2008/5mbi krijimin e rregullave e përgjithshme për kompensimin dhe asistimin e udhëtarëve ne rast te ndalimit te hipjes dhe te anulimit apo vonesave te gjata te fluturimeve.	https://gzk.rks-gov.net/	MMPHI	Mbikëqyrja dhe rregullimi i te drejtave te pasagjereve gjat e udhëtimit me transport ajror në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë të MMPHI

Rregullorja nr.02/2013 mbi te drejtat e personave me aftësi te kufizuara dhe personaveme lëvizshmëri te zvogëluar gjatë udhëtimit nëpërmjet ajrit	https://gzk.rks- gov.net/	MMPHI	Mbikëqyrja dh erregullimi i te drejtave te avioudhëtarëve me aftësi te kufizuara në kuadër të fushëveprimit të Ministrit të MMPHI
---	--	-------	--

Rregullore (AAC) nr. 05/2020 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e agjencisë së bashkimit evropian për sigurinë e aviacionit dhe ndryshimin e rregullores (AAC) nr. 10/2015 dhe shfuqizimin e rregullores (AAC) nr. 11/2009, rregullores (AAC) nr. 03/2009 dhe rregullores (AAC) nr. 6/2009	https://caa.rks-gov.net/	AAC	Mbikëqyrja dhe rregullimi i fushës së aviacionit për sigurinë e civil kuadër fushëveprimi të AAC-së të
Rregullore (AAC) Nr. 01/2020 mbi vendosja e rregullave të përbashkëta ajrore dhe dispozitave operacionale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në navigimin ajror dhe ndryshimin e rregullores (AAC) 07/2012, rregullores (AAC) 03/2016, rregullores (AAC) 15/2010 dhe rregullores (AAC) 08/2017	https://caa.rks-gov.net/	AAC	Mbikëqyrja dhe rregullimi në lidhje me shërbimet dhe procedurat e navigimit ajror në kuadër të fushëveprimit të AAC-së
Rregullore (AAC) Nr. 02/2020 që përcakton kërkesat e përdorimit të hapësirës ajrore dhe procedurat e operimit në lidhje me navigimin	https://caa.rks-gov.net/	AAC	Mbikëqyrja dhe rregullimi i përdorimit të hapësirës ajrore në kuadër të fushëveprimit të AAC-

e bazuar në përformancë			së
----------------------------	--	--	----

Rregullore (AAC) Nr.01/2019 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me opërimet ajrore në bazë të rregullores së AAC- së nr. 03/2009	https://caa.rks- gov.net/	AAC	Mbikëqyrja dh e rregullimi për kërkesat teknike dhe procedurat për opërimet ajrore në kuadër të fushëveprimit të AAC- së
Rregullore (AAC) Nr. 09/2020 për përcaktimin e kërkesave të përbashkëta për ofruesit e shërbimeve të menaxhimit të trafikut ajror/navigimit ajror dhe funksioneve tjera të rrjetit të menaxhimit të trafikut ajror dhe mbikëqyrjen e tyre	https://caa.rks- gov.net/	AAC	Mbikëqyrja dhe rregullimi për menaxhimin e trafikut ajror dhe navigimit ajror në kuadër të fushëveprimit të AAC-së
Rregullore Nr. 08/2018 për vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore të mjeteve ajrore dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike, si dhe për aprovimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra	https://caa.rks- gov.net/	AAC	Mbikëqyrja dhe rregullimi për vlefshmerin e vazhdueshme ajrore te mjeteve ajrore në kuadër të fushëveprimit të AAC- së
Rregullore (AAC) Nr.09/2018 mbi zonat mbrojtëse të aerodromit	https://caa.rks- gov.net/	AAC	Mbikëqyrja dh e përcaktimi i rregullave për zonat mbrojtëse te aerodromit në kuadër të fushëveprimit të

			AAC-së
Rregullore (AAC) Nr. 17/2017 për dispozitatdhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet	https://caa.rks- gov.net/	AAC	Mbikëqyrja dh e rregullimi i procedurave administrative për aerodromet në kuadër të fushëveprimit të AAC-së

Rregullore (AAC) Nr.19/2017 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me licencat dhe certifikatat e kontrollorëve të trafikut ajror	https://caa.rks-gov.net/	AAC	Mbikëqyrja dh erregullimi për licencat dhe certifikatat për kontrollorët e trafikut ajror në kuadër të fushëveprimit të AAC- së
Rregullore 04/2014 mbi licencimin e personelit	https://caa.rks-gov.net/	AAC	Mbikëqyrja dh erregullimi i licencimit te personelit në kuadër të fushëveprimit të AAC-së
Rregullore 04/2011 për qasjen në tregun eshërbimeve në tokë	https://caa.rks-gov.net/	AAC	Mbikëqyrja dh erregullimi për qasjen e eshërbimeve në tokë në kuadër të fushëveprimit të AAC- së
Rregullore Nr. 03/2015 tarifave për aeroportin	https://caa.rks-gov.net/	AAC	Mbikëqyrja, dh e përcaktimi i tarifave për Aeroportin dh e përcaktimin në kuadër të fushëveprimit të AAC- së
Rregullore (AAC) Nr. 03/2019 Për shenjimin e pengesave	https://caa.rks-gov.net/	AAC	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të AAC-së
Rregullore (AAC) Nr.04/2019 Mbi vendosjen e kërkesave për ndarjen e kanaleve të komunikimit me zë për qiellin e	https://caa.rks-gov.net/	AAC	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të AAC-së

vetëm evropian			
Rregullore (AAC) Nr.11/2018 Mbi parashutizmin	https://caa.rks- gov.net/	AAC	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të AAC-së
Rregullore (AAC) Nr.01/2017 Për sistemet emjeve ajrore pa pilot (SAP)	https://caa.rks- gov.net/	AAC	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të AAC-së

Rregullore (AAC) Nr.02/2015 Tarifat e ngarkuara nga AAC	https://caa.rks-gov.net/	AAC	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të AAC-së
Rregullore (AAC) Nr.05/2015 Qe përcaktonkërkesat teknike dhe procedurat administrative ne lidhje me personelin e ekui pazhit ajror te aviacionit	https://caa.rks-gov.net/	AAC	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të AAC-së
Rregullore (AAC) Nr.09/2015 Mbi aerodromet e regjistruara	https://caa.rks-gov.net/	AAC	Mbikëqyrja në kuadër të fushëveprimit të AAC-së
Rregullore nr. 01/2009 për rregullat e përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil;	https://gzk.rks-gov.net/	MPB	Mbikëqyrja dhe rregullimi i fushës për siguri të aviacionit civil në kuadër të fushëveprimit të Ministrit të MPB
Programi kombëtar i sigurisë së aviacionit civil për republikën e Kosovës (niveli i klasifikimit konfidencial);	https://gzk.rks-gov.net/	MPB	Mbikëqyrja e zbatimit të programit për siguri në kuadër të fushëveprimit të Ministrit të MPB
Programi kombëtar i kontrollit të cilësisë për siguri të aviacionit civil për Republikën e Kosovës (niveli i klasifikimit konfidencial);	https://gzk.rks-gov.net/	MPB	Mbikëqyrja dhe rregullimi i programit kombëtar i kontrollit të cilësisë për siguri të aviacionit civil në kuadër të fushëveprimit të Ministrit të MPB

Programi kombëtar trajnues i sigurisë së aviacionit civil për republikën e Kosovës(niveli i klasifikimit konfidencial);	https://gzk.rks-gov.net/	MPB	Mbikëqyrja dhe hartimi i programit kombëtar trajnues për siguri të aviacionit civil në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë tëMPB
---	---	-----	--

Rregullorja nr. mpb-09/2011 - për amendamentin e Rregullores Nr. 01/2009 të MPB-së, e mbështetur në Rregulloren (BE) Nr.18/2010 të Komisionit Evropian e cila amendamentin Rregulloren (KE)Nr.300/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit si dhe specifikimet që kanë të bëjnë me Programet Kombëtare të Kontrollit të cilësisë në fushën e sigurimit të aviacionit civil;	https://gzk.rks-gov.net/	MPB	Mbikëqyrja dhe rregullimi kontrollit të cilësisë në fushën e sigurisë të aviacionit civil nëkuadër të fushëveprimit të Ministrisë të MPB
--	--	------------	---

Rregullorja Nr. MPB-02/2012 - Komisionit Kombëtar të Sigurimit të Aviacionit Civil; Rregullorja (MPB) Nr.01/2016 – për plotësimin e standardeve të përgjithshme themeloretë sigurimit në aviacionin civil; Rregullore (MPB) Nr.04/2020 për vendosjen e kriterëve për të lejuar derogimin nga standardet e përbashkëta themelore mbi sigurimin e aviacionit civil dhe miratimin e masave alternative të sigurimit; Rregullorja (MPB) Nr.01/2022 - për përcaktimin e masave të hollësishme për zbatimin e standardeve themelore të përbashkëtanë fushën e sigurimit të	https://gzk.rks-gov.net/	MPB MPB	Mbikëqyrja që nderlidhet me komisionin kombëtar përsiguri të aviacionit civil në kuadër të fushëveprimit të Ministrisë të MPB
---	--	-----------------------	--

aviacionit.			
Rregullore (KHAIA/ZKM) nr.01 /2022 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (KHAIA/ZKM) nr. 01/2017 për hetimin dhe parandalimin e aksidenteve dhe incidenteve në aviacionin civil	https://gzk.rks- gov.net/	ZKM	Mbikëqyrja dhe përcaktimi i procedurave tecilat kane te bëjnë parandalimin e incidenteve dhe aksidenteve ne aviacionin civil në kuadër të fushëveprimit të ZKM

Për të kuptuar në mënyrë më specifike problemin aktual në fushën që trajtohet me këtë konceptdokument, është zhvilluar dhe elaboruar pema e problemit në vijim.

Duke u bazuar në Udhëzuesin dhe Doracakun për hartimin e koncept dokumenteve dhe në fig. 3 është elaboruar pema e problemit.

Figura 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	1.Ndikimi negativ dhe hamendje ne bashkëpunim nder institucional me paqartësi te dispozitave ligjore te pa precizuara mire. 2.Mos harmonizimi i tërësishëm me te drejtat e pasagjereve në kuadër te HPEA-se. 3. Pa mundësia për rregullimin ekonomik te transportit ajror. 4. Vështirësi në mbikëqyrjen dhe kontrollin e sigurimit të aviacionit civil.
Problem ikryesor	Mungesa e rregullimit adekuat ligjor

Shkaqet	1. Mungesë e përcaktimit të saktë me ligj të një pjese të detyrave dhe përgjegjësive në fushën e të drejtave të trafikut ajror; 2. Mungesa e bazës ligjore për rregullimin ekonomik të transportit ajror; 3. Pa mundësia për të kaluar nga faza I në fazën II pa e bërë fshirjen e paragrafit 2 të nenit 95, të Ligjit për Aviacion Civil që është kërkesë e Komisionit Evropian për të kaluar nga faza I në fazën II në kuadër HPEA. 4. Ligji aktual për aviacion nuk ka specifikuar në detaje detyrat dhe përgjegjësitë e MPB-së për fushën e sigurimit të aviacionit civil, por në vijatë trasha dhe nuk e ka adresuar ruajtjen e personelit për sigurimin e aviacionit civil.
----------------	---

Elaborimi i Shkaqeve

Pas identifikimit të problemit kryesor në vijim në mënyrë kronologjike janë elaboruar shkaqet e problemit:

1. Mungesë e përcaktimit të saktë me ligj të një pjese të detyrave dhe përgjegjësive në fushën e të drejtave të trafikut ajror,

Neni 36 tani nuk është i harmonizuar me nenin 35, të Ligjit për Aviacion Civil nr.03/L-51, të shkaktuara nga momenti i hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 08/L-063.

Tani ka përzierje të kompetencave në mes Ministrisë dhe AAC, sepse neni 35 i ligjit bazik nuk është ndryshuar apo shfuqizuar, ndërsa kompetencat në bazë të nenit 36 janë bartur nga Ministria tek AAC;

2. Mungesa e bazës ligjore për rregullimin ekonomik të transportit ajror; Rregullimi ekonomik i transporti ajror është hequr si kompetencë nga Ministria, ndërsa nuk ju ka bartur AAC-se, këto veprime të shkaktuara me hyrjen në fuqi të Ligjit NR. 08/L-063. Kjo çështje esenciale e rregullimit tani ka mbetur pa kompetenca ligjore për ushtrimin e veprimtarisë së aviacionit civil në Kosovë të bëhet në baze të HPEA.

3. Pa mundësia për të kaluar nga faza I në fazën II pa e bërë **fshirjen e paragrafit 2 të nenit 95**, të Ligjit për Aviacion Civil që është kërkesë e Komisionit Evropian për të kaluar nga faza I në fazën II në kuadër HPEA. Detyrimet e Republikës së Kosovës për të harmonizuar legjislacionin e Kosovës në sektorin e aviacionit me atë të BE-së rrjedhin edhe nga dispozitat rregullative të MSA-së. Neni 53 i MSA-së parashihet që baza e funksionimit të veprimtarisë së aviacionit civil në Kosovë të bëhet në baze të HPEA.

4. Ligji Nr.03/L- 051 për Aviacionin Civil ka hyrë në fuqi në vitin 2008, pas hyrjes së ligjit në fuqi, është krijuar mekanizmi i cili do të merret me sigurimin e aviacionit civil në kuadër të MPB-së. Ky ligj nuk ka specifikuar përgjegjësinë e MPB-së për fushën e sigurimit të aviacionit civil në detale, por ligji i ka përcaktuar dhënien e kompetencave në vijatë

trashë për sigurimin e aviacionit Civil duke e specifikuar se Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për zbatimin dhe aderimin në konventat ndërkombëtare si dhe aspektet e *acquis communautaire* të BE-të të cilat kanë të bëjnë me sigurimin e aviacionit civil dhe nga kjo bazë ligjore janë nxjerre të gjitha të gjitha Rregulloret dhe aktet nënligjore me të cilat ka zhvilluar aktivitetin MPB-Divizioni i Sigurimit të Aviacionit Civil. Gjithashtu, sa i përket burimeve njerëzore (inspektorëve) të cilët monitorojnë zbatimin e rregullave të sigurisë së aviacionit civil, brenda 5 viteve kanë dhënë dorëheqje 3 inspektorë për sigurim të aviacionit civil nga MPB-ja, për shkak të pagës. Për të pajisur me kredenciale një inspektor për siguri të aviacionit civil, duhet të ndiqen disa trajnime të cilat kanë një kosto financiare të madhe dhe punën praktike, e gjithë kjo mund të arrihet minimum për dy vite.

Elaborimi i efekteve

Në vijim është paraqitur elaborimi i efekteve

1. Ndikimi negativ dhe hamendje në bashkëpunim ndër institucional me pa qartësi të dispozitave ligjore të pa precizuara mirë.

Ligji NR. 08/L-063, ka shkaktuar ndikim negativ në bashkëpunim ndër institucional në mes të Ministrisë dhe AAC, për shkak të dispozitave ligjore që i kanë ndryshuar sidomos të nenit 35 dhe 36 të Ligjit për Aviacion Civil por edhe me pa qartësi është përcjellë edhe neni 41 i Ligji NR. 08/L-063.

2. Mungesa e bazës ligjore për rregullimin ekonomik të transportit ajror; Efektet nga mungesa e rregullimit ekonomik të transportit ajror janë të ndieshme, dhe krijojnë hapësirë për zhvillime të pa strukturuara sektoriale dhe të dëmshme për transportin ajror.

3. Mos harmonizimi i tërësishëm me të drejtat e pasagjerëve në kuadër të HPEA-se.

Ky mos harmonizim ka efekt në pamundësinë e kalimit nga faza I në fazën II në kuadër të Marrëveshjes HPEA, e cila është fazë më e avancuar në integrimin e zhvillimit të transportit ajror në mes të anëtarëve nënshkrues të marrëveshjes HPEA.

4. Vështirësi në mbikëqyrjen dhe kontrollin e sigurisë së aviacionit civil

Ministria e Punëve të Brendshme ka pasur vështirësi në kryerjen e aktiviteteve të kontrollit të cilësisë në fushën e sigurisë së aviacionit civil, për shkak të largimit/ikjes së inspektorëve nga ky mekanizëm për shkak të pagës. Si pasojë e kësaj, MPB-ja nuk ka mundur sa duhet të mbikëqyrë dhe kontrollojë sigurimin e aviacionit civil tek entitetet që ofrojnë/merren me sigurim të aviacionit civil.

Kapitulli 1.2. Palët e interesuara

Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës sëinteresuuar	Shkaku-qet me të cilat është e lidhurpala	Efekti-et me të cilatështë e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është elidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)
----------------------------	---	--	--

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, Departament i Aviacionit Civil	1,2,3	1,2,3	MMPHI është përgjegjëse për hartimin e legjislacionit dhe politikave zhvillimore në fushën aviacionit dhe navigacionit ajror.
Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës	1,2,3	1,2,3	AAC, ka autorizimin e nxjerrjës rregulloreve për fushën e navigacionit ajror dhe rregullimit të sigurisë së aviacionit civil dhe trafikut ajror.
Ministria e Punëve të Brendshme – Divizioni për Siguri në Aviacionin Civil	4		MPB, ka përgjegjësinë e Programit për Siguri Kombëtare për sigurimin e aviacionit civil.
ZKM- Komisioni për Hetimin e Aksidentëve dhe Incidenteve të Aeronautikës			ZKM, në kuadër të cilës është KHAIA, kjo e fundit ka përgjegjësinë për parandalimin e incidentëve dhe aksidentëve në trafikun ajror

Kapitulli 1.3. Zbatimi i acquis së BE-së

Gjatë përgatitjes së këtij koncepti dokumenti kemi vlerësuar zbatimin e Acquis BE-së në fushën e aviacionit.

Kemi vlerësuar se në këtë zbatim Kosovën ka arritur rezultatet me të mëdha në krahasim me fushat të tjera. Nevojitet një rishikim i infrastrukturës Ligjore dhe Rregullative në mënyrë që Republika e Kosovës të fillojë fazën II të implementimit të Marrëveshjes Multilaterale Hapësira e Përbashkët Evropiane e Aviacionit Civil.

Aktet e BE-së që rregullojnë fushën e aviacionit civil janë si vijon:

- Licencimi i transportuesve ajror EN••• [Rregullorja (EC) Nr. 1008/2008]
- Qasja për transportuesit ajror të Komunitetit në linjat brenda Komunitetit EN••• [Rregullorja(EC) Nr. 1008/2008]
- Tarifat dhe tarifat për shërbimet ajrore EN••• [Rregullorja (EC) Nr. 1008/2008]
- Kërkesat e sigurimit për transportuesit ajror dhe operatorët e avionëve EN••• [Rregullorja (EC) Nr. 785/2004]
- Kodi i sjelljes për sistemet e kompjuterizuara të rezervimit EN••• [Rregullorja (EC) Nr.80/2009]
- Të dhënat statistikore EN••• [Rregullorja (EC) Nr. 437/2003]
- Rregullat e zbatimit të rregullores së kthimeve statistikore EN••• [Rregullorja e Komisionit(EC) Nr 1358/2003]
- Marrëveshjet e shërbimeve ajrore EN••• [Rregullorja (EC) Nr. 847/2004]
- Mbrojtja kundër subvencionimit EN••• [Rregullorja (EC) Nr. 868/2004]
- Përgjegjësia e transportuesit ajror EN••• [Rregullorja (EC) Nr. 889/2002] |
- Refuzimi i anulimit të hipjes ose vonesa e gjatë e fluturimit EN••• [Rregullorja (EC) Nr261/2004]
- E drejta e personave me aftësi të kufizuara EN•••[Rregullorja (EC) Nr.1107/2006]Harmonizimi EN••• [Rregullorja (EC) Nr. 216/2008]
- Hetimi i aksidentëve dhe incidentëve të aviacionit civil EN••• [Direktiva e Këshillit94/56/EC]
- Rregulla të përbashkëta - themelimi i EASA EN••• [Rregullorja (EC) Nr. 216/2008]
- Raportimi i ndodhive në aviacionin civil EN••• [Direktiva 2003/42/EC]
- Rregullat për vlefshmërinë ajrore EN••• [Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 1702/2003]
- Vlefshmëria ajrore e vazhdueshme EN••• [Rregullorja e Komisionit (EC) Nr 2042/2003]
- Siguria e avionëve të vendeve të treta që përdorin aeroportin e Komunitetit EN•••[Rregullorja (EC) Nr. 216/2008]
- Dokumenti 30 i Konferencës Evropiane të Aviacionit Civil (ECAC-ut);
- Rregullorja e BE-së me Nr.2320/2002 HYPËRLINK "https://integrimievropian.rks-gov.net/wpcontent/uploads/2022/07/Rregullorja_nr._23202002_KE_e_Parlamentit_Evropian_dhe_e_Keshillit_e_16_dhjetorit_2006_qe_percakton_rregullat_e_perbashketa_ne.pdf" qëpërcakton rregullat e përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil;
- Rregullorja e BE-së me Nr.1254/2009 për vendosjen e kriterëve për të lejuar Shtetet Anëtareqë të heqin dorë nga standardet e përbashkëta bazë mbi sigurinë e aviacionit civil dhe të miratojë masa alternative të sigurisë;
- Rregullorja e Komisionit (KE) Nr.272 /2009 për plotësimin e standardeve të përbashkëta themelore mbi Sigurimin në Aviacionin Civil të përcaktuar në Aneksin e Rregullores (KE)Nr.300/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit;
- Rregullorja e (KE) Nr.297/2010 për plotësimin e rregullores Nr.272/2009 të

Komisionit Evropian e cila ndryshon këtë rregullore për plotësimin e standardeve të përbashkëta themelore mbi Sigurimin e Aviacionit Civil;

